



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

OSNOVNI SUD PRIŠTINA - OGRANAK GRACANICA

Broj predmeta: 2023:183716

Datuma: 07.10.2024

Broj dokumenta: 06263362

K.nr.302/23

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA-THEMELORE-PRISHTINË-DEGA NË GRAQANICË - DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES, sipas Gjyqtarit Sinisa Borisavljevic, me pjesëmarrjen e bashkepuntores profesionale Pranvera Ismaili Zhinipotoku , në lëndën e kundërvajtjes kundër kundër të operatorit ekonomik “,,,,,,,,,” sh.p.k , me person pergjegjes ,,,,,, , me seli në magj.Prishtine – Shkup , ne Qagllavic KK Graçanice , per vepren e nga neni 15, Ligji për t regrti me naftë dhe derivat te naftës në Kosovë dhe të nenit,85 dhe 87 Ligji nr.05/L-087 Ligji Per Kundervajtje, Gjykata me dt 02.09.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër operatorit ekonomik “,,,,,,,,,” sh.p.k , me person pergjegjes K, B., me seli në Preoc KK Graçanice, te cilin e perfaqeson A,T,, e lindur me dt., ne Greme, dhe me ID-,,,,,, shtetas I R.Kosoves .

ËSHTË FAJTORE

Sepse,

Inspektoret e Inspektoratit të Tregut - MINT, Sektori i Mbikëqyrjes së Tregut për Naftë dhe Derivate të Naftës në bashkëpunim me Inspektoret e Administrates Tatimore të Kosovës (ATK) me date 03.08.2023 kanë inspektuar Operatorin Ekonomik ,,,,,,,,,, sh.p.k me adresë në magj.Prishtine –Shkup , ne Qagllavic KK Graçanice, lidhur me verifikimin e çmimit maksimal të lejuar për secilin produkt të naftës të përcaktuar me Udhëzimin Administrative nr. 03/2022 për plotësim ndryshimin dhe me Udhëzimit Administrative me U/A Nr. 03/2022 Për Rregullimin e Cmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe Masat tjera Mbrojtëse. Bazuar në raportin e inspektoreve te ATK-se te dates 03.08.2023 me c'rast është konstatuar që Operatori Ekonomik “,,,,,,,,,” sh.p.k, e ka tejkaluar çmimin maksimal të lejuar të shitjes me pakice te produkteve te naftes dhe Krburanteve te Ripërterishme.

Me këtë veprim i ka kryer kundervajtje nga neni 15 të Ligjit nr.08/L-018PërTregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme", i cili sanksionohet me nenin 19 paragrafi 13 të po të njëjtit ligj; dhe në nenin 26 të Ligjit nr. 06/L-034 „Për Mbrojtjen e Konsumatorit" dhe ndëshkohet me nenin 137 të po të njëjtit ligj. andaj shqiptohet ky Aktgjykim me te cilin :

D E N O H E T

Me DENIM ME GJOBE në shumë prej **1.000 (njemi)** Euro, për kundërvajtje të kryer, e cilai ngarkohet atij siç u tha më lart. I pandehuri do të paguajë dënimin e shqiptuar brenda 30 ditëve nga dita kur ky Aktgjykim merr formë të prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit të etyruar.

Nëse nuk e paguan në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për përmbarim.

I pandehuri, obligohet që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **10 € (dhjetë euro)** në afatin e njëjtë sikurse denimin në të holla në kuptim të nenit 59, dhe 76, të LK-së.

A r s y e t i m

Ministria e Industrisë - Inspektorati I Tregut ne Prishtine , kësaj Gjykate i ka parashtruar Kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr.4941-19 datë 22.08.2023 e cila është pranuar ne kete gjykat me dt.30.08.2023 kundër të pandehurit të lartëshenuar, për kundërvajtjen e kryer si në hyrje të këtij aktgjykimi

Gjykata mori në pyetje, palën e pandehur, u paraqit në Gjykatë për te dhënë deklaratë me dt. 27.08.2024 perfaqesuesi i operatorit ekonomik ,, ,, ,, ,, ,, ,, ,, ,, ,, ,, sh.p.k deklaron: I pandehuri ne pyetje te gjykates se a e pranon vepren per te cilet akuzohet , **I njeiti deklaroj se e pranon fajësinë** për veprën që I ngarkohet operatorit ekonomik , dhe kerkoj nga gjykata qe te shqiptoj nje denim me te ulet per arsye se ishte nje tejkalm minimal i qmimit ne vlere prej 0.001 cent .

Pasi që i pandehuri e ka pranuar veprën kundërvajtëse për të cilën po ngarkohen , gjykata nuk i ka ftuar inspektorët e Tregut MINT –Parashtruesit e Kerkeses që ta merë mendimin e tyre.

Në bazë të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse, deklaratës së të pandehurit , pranimi te fajsis si dhe shkresave tjera të lëndës, gjyqtari pa mëdyshje konstatoi se i pandehuri ka kryer veprën kundërvajtëse të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për çka dhe u shpallën përgjegjës dhe u dënua siç u cek më lartë.

Me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, gjyqtari morri parasysh rrethanat e parapara me nenin 31, dhe 35, të Ligjit për Kundërvajtje, e sidomos peshën e veprës kundërvajtëse dhe pasojat, rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, shkallën e përgjegjësisë, si dhe sjelljet e tyre para dhe pas kryerjes së kundërvajtjes të cilën e vlerësoi si rrethanë lehtësuese, ndërkaq rrethana rënduese nuk gjeti në rastin konkret , andaj bazuar në të gjitha këto rrethana, të pandehurve iu shqiptua një dënim i tillë me bindje se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Me sa u tha me lartë u vendos si ne dispozitiv te këtij Aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-Dega Graçanice
Departamenti i pergjithshem, Divizioni per Kundervajtje
K.nr 302/23 nga 02.09.2024.

Bashkepuntore Profesionale
Pranvera Ismaili Zhinipotoku

Gjyqtari
Sinisa Borisavljevic

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej **8 ditësh** nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit-Departamenti për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.